



19 KORRIK 2015

## MBI TRENDIN SHQETËSUES TË INCIDENTEVE TË DREJTUARA NDAJ KOMUNITETIT SERB NË REGJONIN E PEJËS DHE KLINËS

Gjatë dhjetë ditëve të fundit, është shënuar një rritje e konsiderueshme e numrit të incidenteve ku është i përfshirë komuniteti serb në regionin e Pejës dhe Klinës. Raportohet se më 8 dhe 9 korrik në Gorazhdec, fshat me shumicë serbe në Komunën e Pejës, kanë ndodhur disa incidente që përfshijnë një sulm me armë drejtuar një veturë (me targa të Serbisë) pronë e familjes Kolašinac, si dhe një incident tjetër që kishte të bënte me një përpjekje për t'i vënë zjarr monumentit për fëmijët e vrarë në Gorazhdec në vitin 2003.<sup>1</sup> Për më tepër, mbishkrime në mur që thoshin "Hakmarrje" u gjetën në afërsi të kishës së fshatit.<sup>2</sup> Disa ditë më vonë, një polic i Policisë së Kosovës u qëllua me armë dhe u plagos nga një hajdut i supozuar gjatë një vjedhjeje në tentativë.<sup>3</sup> Në një incident të ndarë, është raportuar se një kishë në fshatin Dërsnik në Komunën e Klinës ishte vjedhur dhe se disa prona të saj ishin dëmtuar.<sup>4</sup> Një tjetër incident ndodhi në Brestovik ku u raportua se familja Dešić ishte sulmuar dhe në të ishte qëlluar me armë.<sup>5</sup>

Ministri për komunitete dhe kthim, Dalibor Jevtić, i dënoi këto incidente dhe i bëri thirrje policisë dhe autoriteteve komunale që ta marrin seriozisht këtë trend të incidenteve dhe të fillojnë t'i ofrojnë mbrojtje të vërtetë komunitetit serb. Deklarata e ministrit Jevtić tregoi për një frustrim dhe zhgënjim në rritje e sipër në lidhje me këto incidente të përsëritura, por megjithatë ministri ishte këmbëngulës se këto incidente nuk do ta vonojnë apo ndalojnë procesin e kthimit, dhe se ministria e tij do të vazhdojë të punojë për ofrimin e mbrojtjes dhe sigurisë për të kthyerit serb në këto vende.<sup>6</sup> Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, gjatë një vizite në Gorazhdec për të inauguruar një projekt infrastrukturor bisedoi me qytetarët atje dhe u kumtoi mbështetjen e tij për komunitetin dhe premtoi se komuna do të investojë më shumë në fshat për të mirën e gjithë qytetarëve atje.<sup>7</sup> Kryetari i Komunës së Klinës, Sokol Bashota, gjithashtu dënoi vjedhjen e kishës në Dërsnik gjatë një vizite në kishë dhe fshat.<sup>8</sup>

Incidentet e fundit ndodhën një kohë të shkurtër pasi u raportua për një seri incidentesh në Klinë majin e kaluar, kur anëtarë të komunitetit serb të sapokthyer në fshat pas shumë vitesh ishin viktima të vjedhjeve dhe abuzimit verbal, për të cilat vjedhje dhe abuzime autorët e

<sup>1</sup> <http://www.rtklive.com/?id=2&r=36325>

<sup>2</sup> <http://www.radiokim.net/vesti/hronika/preteci-grafit-u-gorazdevcu.html>

<sup>3</sup> <http://koha.net/?id=27&l=66362> dhe [http://kossev.info/strana/arhiva/ranjen\\_policajac\\_u\\_gorazdevcu/5582](http://kossev.info/strana/arhiva/ranjen_policajac_u_gorazdevcu/5582)

<sup>4</sup> [http://kossev.info/strana/arhiva/ponovo\\_obijena\\_crkva\\_u\\_drniku/5511](http://kossev.info/strana/arhiva/ponovo_obijena_crkva_u_drniku/5511)

<sup>5</sup> <http://www.rtklive.com/rtk2/?id=2&r=2500>

<sup>6</sup> <http://www.mkk-ks.org/?page=1,12,884>; <http://www.rtklive.com/rtk2/?id=2&r=2500>.

<sup>7</sup> <http://www.mkk-ks.org/?page=1,12,885>

<sup>8</sup> <https://kk.rks-gov.net/kline/News/Reagon-Kryetari-i--Komunes-se-Klines,-z--Sokol-Bas.aspx>

dyshuar ishin arrestuar nga Policia e Kosovës.<sup>9</sup> Kjo seri e sulmeve dhe dëmtimit të pronës e drejtuar ndaj komunitetit serb në Kosovën perëndimore, edhe pse fatmirësisht nuk ka shkaktuar ndonjë dëm serioz fizik, megjithatë flet për një tendencë në rritje të incidenteve që për cak kanë komunitetin serb në atë regjion, dhe ky trend nuk mund të hidhet poshtë me arsyetimin se janë incidente të izoluar. Ky trend jo vetëm që paraqet rrezik që procesi i kthimit në Kosovë seriozisht të ngadalësohet apo ndalohe, por komplikon edhe më tej situatën komplekse dhe fragjile në të cilën gjendet komuniteti serb në Kosovë, veçanërisht ai në Kosovën perëndimore.

Në këtë drejtim, veprimet e ndërmarra nga institucionet e Kosovës dhe autoritetet tjera që janë të mandatuara për mbajtjen e paqes, rendit dhe sigurisë për gjithë qytetarët e Kosovës—pavarësisht etnisë së tyre—janë vendimtare në sigurimin e komunitetit serb dhe gjitha komunitetet tjera në përgjithësi që këto institucione kanë vullnetin dhe gatishmërinë e duhur për të ofruar këtë mbrojtje dhe për të sjell një ndienjë normaliteti në jetën e tyre. Prezenca dhe vigjilenca e shtuar e Policisë së Kosovës në këto vende si dhe konsultimet e shpeshta me komunitetet e vendit nëpërmjet Komiteteve Komunale për Siguri në Bashkësi ofrojnë një platformë për dialog, ndërtim të besimit të ndërsjellë dhe raportim, dhe mund t'i ndihmojnë policisë që të krijojë strategji parandaluese.

Arrestimi i shtatë të dyshuarve për vjedhjet e majit të kaluar është për t'u lëvduar, dhe do të ishte shenjë pozitive në drejtimin e duhur nëse policia arrin që ta bëjë të njejtën gjë dhe t'i arrestojë kryerësit e këtyre incidenteve të korrikut. Sidoqoftë, arrestimet duhet të përcillen me gjykime të shpejta ku të dyshuarit, nëse gjenden fajtorë, dënohen për këto vepra; kjo do t'i dërgonte mesazh të gjithë tjerëve—duke përfshirë këtu komunitetet minoritare—se institucionet e Kosovës janë serioze dhe të vendosura që t'i mbrojnë të drejtat themelore të njeriut për jetë dhe pronë, me shpresën se kjo do të shërbente edhe si element dekurajues për ata që aspirojnë të kryejnë sulme të tilla, apo për ata që inspirojnë këto sulme.

Për në fund, ashtu siç kemi nënvizuar edhe më parë, vetëm deklaratat e dënimit të sulmeve nuk mjaftojnë, posaçërisht për viktimat, komunitetin serb, dhe të kthyerit në përgjithësi, të cilët veçse janë të cënueshëm gjatë hedhjes së hapit të tyre të parë në tranzicionin e gjatë drejt integritimit në shoqëri kosovare. Dënimi personal dhe vizitat që i kanë bërë këtyre vendeve kryetarët e komunave të Pejës dhe Klinës janë shenjë e mirë meqë këto veprime përçojnë mesazhin se incidente si këto janë të papranueshme për komunitetin shumicë. Sidoqoftë, këto deklarata përbëjnë një përjashtim, meqë incidente si këto duket se janë fushëveprimtari e kufizuar për politikanët serbë në Kosovë (ministri Jevtić) dhe Serbi (drejtori I Zyrës për Kosovë, Marko Đurić). Ashtu siç e ka cekur edhe ECMI Kosova në të kaluarën, çështjet që i përkasin komuniteteve nuk janë fushëveprimtari ekskluzive e përfaqësuesve të minoriteteve, dhe mesazhi për t'i dhënë fund këtyre incidenteve dhe për kryerësit të dënohen ashtu siç ju takon në bazë të krimeve të kryera do të fitonte në fuqi kur ai mesazh të dërgohet haptazi nga përfaqësuesit e komunitetit shumicë gjithashtu.

<sup>9</sup> Për më shumë detaje në lidhje me këto incidente, shih raportin e ECMI Kosovës: [Rreth incidenteve të fundit në Klinë dhe procesin e ngadalshëm të kthimit](#) (21 maj 2015).

**Raporte dhe analiza politike të tjera të realizuara nga ECMI Kosova:**

[Vivovdani: Mungesa e lajmeve është lajm i mirë](#)

**2 korrik, 2015**

[Rreth incidenteve të fundit në Klinë dhe procesin e ngadalshëm të kthimit](#)

**21 maj, 2015**

[Dita memoriale e goranëve më 6 maj: Një mundësi e humbur për institucionet e Kosovës](#)

**14 maj, 2015**

[Me rastin e incidentit të fundit në Pasjan](#)

**10 maj, 2015**

[Buxhetet e komunave veriore të Kosovës: Marrëveshje më në fund](#)

**7 maj, 2015**

[Incidentet dhe tensionet në Mitrovicë: Nevoja për raportim objektiv dhe forcim të sundimit të ligjit](#)

**21 prill, 2015**

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Çfarë është e \(pa\)mundur në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës?](#)

**16 prill, 2015**

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Një klub ekskluziv I bazuar në përkatësinë etnike?](#)

**31 mars, 2015**

[Komunitetet pakicë jo-serbe të neglizhuar në marrëveshjet teknike në mes të Kosovës dhe Serbisë](#)

**10 mars, 2015**

[Deklarata kontroverze e Ministrit Murati dhe reagimet që pasuan](#)

**5 mars, 2015**

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Shumë spekulime, pak marrëveshje faktike dhe mos-zbatim](#)

**22 shkurt, 2015**

[Një sistem juridik dhe gjyqësor i unifikuar në Kosovë?](#)

**15 shkurt, 2015**

[Çfarë duhet të mbahet mend nga rasti Jablanović?](#)

**8 shkurt, 2015**

[Farkimi i një mjedisi pune në kuadër të Qeverisë së Kosovës](#)

**Rreth ECMI Kosovës**

**19 janar, 2015**

[Formimi i qeverisë së re të Kosovës, përfaqësimi i komuniteteve pakicë dhe sfidat në të ardhmen](#)

**10 dhjetor, 2014**

# KOSOVO COMMUNITIES ISSUES MONITOR

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumetnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëvepruar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.